



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR MBIKËQYRJEN E SHËRBIMIT CIVIL

Adresa: Bulevardi "Zogu I", Godina 57/2, Nr.18 Tirane

Tel/Fax 04 2226814 ; 2226814

Nr. 438/6 akti

Tiranë, më 15.07. 2015

V E N D I M

Nr. 70, datë 15.07 /2015

**Mbi përfundimin e procedimit administrativ, filluar me urdhrin e verifikimit
nr. 438/1, datë 17.06.2015**

Bazuar në urdhrin e verifikimit nr. 438/1, datë 17.06.2015, lidhur me rastin e paraqitur nga nëpunësi ***** , me detyrë Specialist në Drejtorinë e Pagesave dhe Dëshmshpërblimeve në Drejtorinë e Përgjithshme të Thesarit pranë Ministrisë së Financave, në lidhje me zbatimin e vendimit nr. 54, datë 06.02.2006, të ish-Komisionit të Shërbimit Civil, sipas kërkesave të ligjit nr.152/2013, "Për nëpunësin civil", i ndyshuar me ligjin nr.178/2014 neni 24 dhe 62 i ligjit, dhe mbështetur në nenin 13, 14 gërma "a" dhe nenin 34 të Rregullores "Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit", miratuar me Vendimin nr.17 datë 11.03.2015,

VËREJ:

Pas verifikimit të dokumentacionit të praktikës në fjalë, të vënë në dispozicion nga sektori i Burimeve Njerëzore të Drejtorisë së Shërbimeve Juridike të Drejtorisë së Përgjithshme së Shërbimeve Mbështetëse pranë Ministrisë së Financave, rezultoi:

Nëpunësi ***** ka punuar Specialist në Sektorin e Shërbimeve Sociale dhe Administrative në Drejtorinë e Menaxhimit dhe Zbatimit të Buxhetit pranë Ministrisë së Financave kategoria III-b. Gjatë ristrukturimit të Ministrisë së Financave, me Urdhrin nr. 180, datë 17.11.2005, të Kryemnistrit, ***** është larguar nga shërbimi civil me urdhrin nr. 31, datë 04.01.2006, të Ministrit të Financave, për shkak të mbylljes të vendit të tij të punës. Nëpunësi ***** ka ankimuar urdhrin e lirimit të tij te ish-Komisioni i Shërbimit Civil (*organi kompetent për shqyrtimin e rastit në atë kohë*). Ky Komision, pasi mori në shqyrtim ankesën e ***** , me vendimin nr. 54, datë 06.02.2006, vendosi: "*Shfuqizimin e urdhërit nr. 31, datë 04.01.2006, si akt të pabazuar në ligj; Detyrimin e Ministrisë së Financave për të bërë pagesën që nga dita e ndërprerjes së marrëdhënieve financiare deri në zbatimin e këtij vendimi me pagën që kishte në momentin e ristrukturimit*".

Në zbatim të vendimit të ish-Komisionit të Shërbimit Civil dhe ndodhur para faktit se në Drejtorinë e Buxhetit nuk kishte vende vakante me kategori page III-b, me urdhrin nr. 3979/5 prot., datë 29.10.2014, të Ministrit të Financave, ky nëpunës emërohet në pozicionin Specialist

në Drejtorinë e Pagesave dhe Dëmshtëpërblimeve në Drejtorinë e Përgjithshme të Buxhetit, pranë Ministrisë së Financave, me kategori page IV-a (*efektet e këtij akti fillojnë në datën 01.11.2014*) dhe me aktin nr. 3520/2 prot., datë 05.12.2014, të Departamentit të Administratës Publike, emërohet nëpunës civil në pozicionin e mësipërm.

Në vazhdim, me urdhrin e Kryeministrit nr. 45, datë 31.03.2015, me lëndë "*Për miratimin e strukturës dhe organikës së Ministrisë së Financave*", është ndryshuar struktura dhe organika e Ministrisë së Financave. Ky ristrukturim, mes të tjerash, përcaktoi kalimin e Drejtorisë së Pagesave dhe Dëmshtëpërblimeve (*drejtori ku punonte nëpunësi në fjalë*) nga Drejtoria së Përgjithshme e Buxhetit në Drejtorinë e Përgjithshme të Thesarit. Në zbatim të strukturës së re, si dhe të propozimit të Komisionit të Ristrukturimit, Departamenti i Administratës Publike, në cilësinë e njësisë përgjegjëse, me aktin nr. 1464/77 prot., datë 05.06.2015, vendosi të transferojë

***** në pozicionin specialist në Drejtorinë e Pagesave dhe Dëmshtëpërblimeve në Drejtorinë e Përgjithshme të Thesarit pranë Ministrisë së Financave.

Sa më sipër, arrihet në konkluzionin se:

Urdhri nr. 3979/5 prot., datë 29.10.2014, i Ministrit të Financave, është në zbatim të vendimit nr. 54, datë 06.02.2006, të ish-Komisionit të Shërbimit Civil. Pavarësisht se ***** nuk ka dhënë pëlqimin e tij, ai ka punuar dhe vazhdon aktualisht të punojë në pozicionin Specialist në Drejtorinë e Pagesave dhe Dëmshtëpërblimeve në Drejtorinë e Përgjithshme të Buxhetit pranë Ministrisë së Financave. Paraqitja e tij në detyrë për rreth 8 muaj, edhe pse kategoria e pagës nuk është e njëjtë me atë që kishte në momentin e lirimit nga shërbimi civil, konsiderohet pranim në heshtje të pozicionit të tij të punës.

Lidhur me pretendimin e ***** për ndryshimin e klasifikimit të pagës, konstatojmë se:

- Ristrukturimet ndër vite të miratuara nga organet kompetente kanë ndryshuar strukturën e Ministrisë së Financave duke sjellë ndryshimin e numrit të punonjësve dhe kategorive të pagave të pozicioneve të punës në drejtoritë e saj. Në këto rrethana, është objektivisht i pamundur rikthimi në të njëjtin vend pune i punonjësve me vendim gjyqësor, por është i mundur rikthimi i tyre në një pozicion të ngjashëm, duke ruajtur kategorinë e pozicionit të punës. Kategorizimi i pagës nuk është element i cilësimit të pozicionit të punës.
- Në nenin 19, të ligjit nr. 152/2013 "*Për nëpunësin civil*", i ndryshuar, citohet se "*Nëpunësi civil të kategorisë ekzekutive janë specialistët*". Nëpunësi ***** është rikthyer në punë në kategorinë ekzekutive specialist; emërtesa dhe kategoria ngelet "*specialist*", nga ku rezulton se ruhet niveli i statusit të punësimit.

Transferimi i përhershëm i nëpunësit ***** , me aktin nr. 1464/77 prot., datë 05.06.2015, të Departamentit të Administratës Publike, në zbatim të urdhrin të Kryeministrit nr. 45, datë 31.03.2015, me lëndë "*Për miratimin e strukturës dhe organikës së Ministrisë së Financave*", është bërë në përputhje me kërkesat e nenit 50, të ligjit nr.152/2013, "*Për nëpunësin civil*", i ndryshuar, dhe të kreut III "*Transferimi për shkak të mbylljes dhe ristrukturimit të institucionit*", të VKM nr. 171, datë 26.03.2014 "*Për transferimin e përhershëm dhe të përkohshëm të nëpunësve civilë, pezullimin dhe lirimin nga shërbimi civil*".

Komisioni i Ristrukturimit ka shqyrtuar mundësitë e sistemit të çdo nëpunësi civil në vendet e lira ekzistuese dhe ka propozuar transferimin e nëpunësit në fjalë në një pozicion të lirë, në të cilin ai plotësonte kërkesat specifike. Vendimi përfundimtar i transferimit është marrë nga njësia përgjegjëse, në bazë të propozimit të komisionit.

Ripozicionimi i tij si Specialist në Drejtorinë e Pagesave dhe Dëshmshpërblimeve në Drejtorinë e Përgjithshme të Thesarit, pranë Ministrisë së Financave, me kategorinë e pagës IV-a, është kryer me anë të një transferimi të përhershëm të rregullt, sipas kërkesave të ligjit.

Për këto arsye,

në mbështetje të kompetencave ligjore të përcaktuara në nenin 11 pika 1 dhe 14 të ligjit nr. 152/2013 *"Për nëpunësin civil"* të ndryshuar, si dhe nenin 34 të Rregullores *"Mbi Procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit"* të miratuar me Vendimin nr.17 dt.11.03.2015 të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil

V E N D O S A:

Përfundimin e procedimit administrativ, iniciuar në bazë të Urdhërit nr. 438/1, datë 17.06.2015, "Për verifikimin e rastit të paraqitur nga ***** në lidhje me zbatimin e vendimit nr. 54, datë 06.02.2006, të ish-Komisionit të Shërbimit Civil".

Të njoftohen për këtë vendim Departamenti i Administratës Publike, sektori i Burimeve Njerëzore të Drejtorisë së Shërbimeve Juridike të Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimeve Mbështetëse pranë Ministrisë së Financave dhe nëpunësi *****.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONERI

Pranvera STRAKOSHA